

- DEKLARATA E EKSPERTIT -  
**PERSPEKTIVAT SHËNDETËSORE NË PROCESIN VENDIMMARRËS**

Reagimi shëndetësor ndaj ndotjes zero të ajrit në rajonin e Ballkanit

Ndotja e ajrit është faktori kryesor mjedisor që rrit rrezikun për sëmundje, duke shkaktuar një barrë të madhe për shëndetin. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), ndotja e ajrit nga burimet e brendshme dhe të jashtme shkakton shtatë milionë vdekje të parakohshme në mbarë botën çdo vit (OBSH, 2018). Të dhënat e OBSH-së tregojnë se 99% e popullsisë totale globale thith ajër që konsiderohet i dëmshëm për shëndetin<sup>1</sup>, sidomos në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që vuajnë nga ekspozime më të larta.

Ndotja e ajrit është shkak i dytë kryesor i vdekjeve nga sëmundjet jo të transmetueshme (SKK)<sup>2</sup>, duke shkaktuar sëmundje ishemike të zemrës, goditje në tru, sëmundje kronike obstruktive pulmonare, infeksione të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes dhe kancer të mushkërive. Studimet e reja gjithashtu e lidhin ndotjen e ajrit me një rrezik më të lartë të diabetit, astmës dhe demencës, duke ndikuar në zhvillimin e trurit të fetusit dhe fëmijëve me efekte të mundshme gjatë gjithë jetës (probleme psikologjike dhe të sjelljes që shfaqen më vonë në jetë, duke përfshirë simptomat e çrregullimit nga deficit i vëmendjes dhe hiperaktiviteti (ADHD)<sup>3</sup>, ankth dhe depresion). Ndotja e ajrit çon në një barrë të madhe shëndetësore për individin dhe shoqërinë, e reflektuar në një sërë ditësh sëmundjesh, vizita te mjeku, përdorimi i ilaçeve, shtrimet në spital, duke shtuar kostot e mëdha të kujdesit shëndetësor në Ballkanin Perëndimor. Ndotja e ajrit prek të gjithë, por ka një efekt veçanërisht të dëmshëm te grupet e cenueshme, si të moshuarit dhe pacientët me sëmundje kronike, fëmijët, gratë shtatzëna dhe njerëzit që jetojnë në mjedise sfiduese socio-ekonomike.

Dëshmitë po rriten edhe në lidhje me efektet e dëmshme të ndotjes edhe kur janë në nivele të ulëta, duke vënë në dukje faktin se mund të mos ketë ndonjë nivel të sigurt ekspozimi.

Për t'i dhënë fund dëmit shëndetësor nga ndotja e ajrit kërkohen veprime të vendosura dhe urgjente parandaluese si dhe vullnet e përkushtim politik në të gjitha nivelet dhe sektorët e politikëbërjes. Mbrojtja e çdo qenieje njerëzore nga ndotja e ajrit – veçanërisht mbrojtja e personave më të cenueshme nga ana shëndetësore – kërkon zhvillimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin e sëmundjeve që bazohen në shkencën më të fundit, kanë prioritet parandalimin dhe masat paraprake dhe janë të përfshira në legjislacionin detyrues me qëllime dhe afate të qarta kohore.

---

<sup>1</sup> World Health Organization (2021). WHO global air quality guidelines: particulate matter (PM2.5 and PM10), ozone, nitrogen dioxide, sulfur dioxide and carbon monoxide.

<sup>2</sup> World Health Organization (2019). Noncommunicable diseases and air pollution, WHO European High-Level Conference.

<sup>3</sup> UNICEF (2017). Danger in the air: How air pollution can affect brain development in young children.

Cilësia e dobët e ajrit është një shqetësim i madh në Ballkanin Perëndimor, njerëzit ekspozohen ndaj përqendrimeve të larta të ndotësve të dëmshëm gjatë gjithë vitit, mbi kufijtë kombëtarë. Burimet e ndotjes përfshijnë trafikun, me një numër të madh automjesh të vjetruara, industrinë e rëndë, bujqësinë, djegien e qymyrit dhe drurit për ngrohje dhe gatim, djegien e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë, termocentralet e vjetra të qymyrit që lëshojnë sasi të mëdha të grimcave, dioksid sulfuri dhe oksid azoti. Ndotja nga grimcat konsiderohet më e rrezikshme për shëndetin e njeriut.

Në vitin 2019, Agjencia Evropiane e Mjedisit ka treguar se grimcat e imëta PM2.5 shkaktuan më shumë se 25 000 vdekje të parakohshme vetëm në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor: 4 000 në Shqipëri, 5 900 në Bosnje dhe Hercegovinë, 2 800 në Kosovë\*, 900 në Mali i Zi, 3 400 në Maqedoninë e Veriut dhe në 11 400 në Serbi. Në të njëjtin vit, më shumë se 2 200 persona humbën jetën për shkak të ndotjes së dioksidit të azotit (NO<sub>2</sub>) dhe ozonit (O<sub>3</sub>)<sup>4</sup>.

Qeveritë rajonale vazhdojnë të financojnë industrinë e djegies së lëndëve fosile, veçanërisht termocentralet e qymyrit që shkaktojnë ndotje lokale të ajrit, tokës dhe ujit. Komunitetet pranë termocentraleve të qymyrit dhe objekteve të mëdha industriale janë prekur më shumë, por për shkak të kushteve klimatike, ndotja është përhapur në të gjithë rajonin duke prekur jetën e njerëzve, kafshëve të egra dhe natyrën. Duket se qytetarët po vazhdojnë të financojnë rimëkëmbjen e shëndetit publik, ekonomisë dhe mjedisit jetësor.

Ndotja e ajrit dhe ndryshimet klimatike janë kërcënimet kryesore për shëndetin në rajon. Rajoni është goditur tashmë nga ngjarje ekstreme klimatike si valët e të nxehtit, përmytjet masive, stuhitë e shiut dhe erës dhe thatësitat, të gjitha këto çojnë në humbje të mëdha shëndetësore, mjedisore dhe ekonomike: këto ngjarje klimatike kanë rritur cenueshmërinë e shëndetit në shumë komunitete dhe ekosisteme duke ngadalësuar gjithashtu hedhjen e hapave drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme. Nëse nuk merren masa, ndryshimet klimatike do të vazhdojnë të ndikojnë në rritjen e temperaturave dhe valëve të të nxehtit, si dhe në ngjarjet ekstreme të motit që së bashku me ndotjen e ajrit, ndikojnë negativisht në shëndet, duke na kujtuar nevojën për të vepruar urgjentisht për t'i dhënë fund varësisë nga karburantet fosile në rajon, që nxisin ndryshimet klimatike dhe janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit.

Ndotja e ajrit dhe ndryshimet klimatike kanë një burim të përbashkët: djegien e lëndëve fosile. Përpjekjet për të reduktuar njërën mund të përmirësojnë tjetrën. Përmirësimi i cilësisë së ajrit mund të ndihmojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe ulja e emetimeve do të ndihmojë në cilësinë e ajrit. Duke arritur nivelet e Udhëzimit të Cilësisë së Ajrit nga OBSH, Ballkani Perëndimor do të arrijë të ruaj shëndetin publik si dhe të zbusë ndryshimet klimatike.

---

<sup>4</sup> Eionet (2021). Health risk assessments of air pollution Estimations of the 2019 HRA, benefit analysis of reaching specific air quality standards and more.

\* Ky apelim nuk paragjykon pozicionin mbi statusin dhe është në përputhje me UNCRC 1244/99 dhe Opinionin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## **REKOMANDIME SHËNDETËSORE PËR POLITIKËBËRËSIT**

Politikëbërësit në rajon duhet të identifikojnë dhe t'u japin përparësi masave që do të ofrojnë përfitime të madha në shëndet, klimë dhe ajër të pastër. Ndotja e ajrit është një kërcënim publik dhe duhet të trajtohet përmes veprimeve ambicioze dhe të qëndrueshme që synojnë një të ardhme më të shëndetshme. Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet të rrisin pjesëmarrjen e shkencës në proceset vendimmarrëse për të siguruar integritetin në kohë të objektivave të Ndotjes Zero të Ajrit në politikat mjedisore.

Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet të njohin rolin e rëndësishëm të autoriteteve të qytetit në kryerjen e veprimeve për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe zbutjen e efektit të ndryshimeve klimatike. Funksionimi i decentralizimit kërkon financim, përgjegjshmëri, monitorimi dhe efektivitet në investime, ofrim të politikave nga qytetet në mënyrë që të menaxhohet reagimi i shpejtë ndaj uljes së ndotjes së ajrit në burimet ndotëse. Kjo do të thotë gjithashtu se më shumë ekspertë të shëndetit dhe mjedisit duhet të bashkojnë përpjekjet për të marrë vendime të bazuar në shkencë, që synon ndërtimin e një të ardhmeje më të shëndetshme, më të pastër dhe të qëndrueshme për të gjithë.

**Ne, ekspertët e poshtëshënuar të shëndetësisë që punojmë në Ballkanin Perëndimor bëjmë thirrje për sa vijon:**

### **Përcaktoni një objektiv dhe afat kohor për Zero Ndotje**

Deklarata e Sofjes mbi Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj janë korniza të rëndësishme të politikave për arritjen e ajrit të pastër duke prezantuar politikën Zero Ndotje Ajri në rajon dhe një mundësi e shkëlqyer për të drejtuar investimet në kuadër të Planit Ekonomik dhe Investiv për Ballkanin Perëndimor. Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet të përcaktojnë objektivin ambicioz për arritjen e një mjedisi pa ndotje, që do të ndiqet përgjatë një afati kohor të qartë.

Emergjencat më të fundit si sëmundja Coronavirus (COVID-19), kriza financiare dhe energjitike si dhe Lufta në Ukrainë kanë ngadalësuar progresin drejt një të ardhmeje më të shëndetshme në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Këto rrethana kërcënuese për jetën kanë rritur cenueshmërinë e komuniteteve tona, me në krye shëndetin e njerëzve. Udhëheqësit duhet të promovojnë më shumë investime që përdorin energjinë e rinovueshme në vend të lëndëve djegëse fosile, uljen e ndotjes për të parandaluar sëmundjet, zbutjen e ndryshimeve klimatike, gjelbërimin e qyteteve dhe rritjen e lëvizshmërisë inteligjente. Hapat e rimëkëmbjes në vazhdim duhet të konsiderohen si mundësi për të ofruar një të ardhme të sigurt, më të shëndetshme dhe të qëndrueshme për të gjithë.

## **PËR UDHËHEQËSIT E BALLKANIT PERËNDIMOR:**

- Angazhohuni për të arritur plotësisht standardet kombëtare të cilësisë së ajrit nga Udhëzimet për Cilësinë e Ajrit të Organizatës Botërore të Shëndetit 2021, sa më shpejt të jetë e mundur.
- Krijimi i bashkëpunimit rajonal për të përshpejtuar lëvizjen drejt Ndotjes Zero të Ajrit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet ministrive të shëndetësisë dhe mjedisit, instituteve të shëndetit publik dhe ekspertëve shëndetësorë.
- Rrisni e pjesëmarrjen e ekspertëve të shëndetësisë, komunitetit shkencor dhe akademisë në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimit të politikave.
- Përfundimi i subvencioneve publike direkte ose indirekte të proceseve ndotëse, veçanërisht djegies së karburanteve fosile për prodhimin e energjisë, për ngrohjen dhe gatimin.
- Përcaktoni një datë ambicioze për heqjen e qymyrit për prodhimin e energjisë, mbështetur me financim për burimet e rinovueshme të energjisë.
- Ofroni mbështetje për t'i dhënë fund djegies së qymyrit dhe drurit për gatim dhe ngrohje, dhe kalimit në alternativa më të pastra.
- Mbështetni qytetet në zbatimin e politikave për heqjen nga përdorimi i automjeteve të vjetra me naftë (importi dhe përdorimi) dhe futjen e infrastrukturës së makinave elektrike, si dhe reduktimin e trafikut nga mjetet motorike, zgjerimin e transportit publik dhe infrastrukturës aktive të udhëtimit (përdorimi i biçikletës, ecje).
- Finalizimi i procesit të ratifikimit të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Gjatë dhe angazhimi për zbatimin ambicioz të protokolleve.
- Mbështetni modelet për të përkrahur ekonomikisht angazhimet për reduktimin e emetimeve nga ndotësit kryesorë të mbuluara nga Planet Kombëtare të Reduktimit të Emisioneve (sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Direktiva 2001/80/EC) dhe Protokollit i Goteborgut sipas Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Gjatë.
- Rritja e përdorimit të teknikave më të mira të disponueshme në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale.
- Siguroni fonde për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive të Cilësisë së Ajrit në nivel Qyteti që synojnë forcimin e shëndetit parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Krijimi i një sistemi adekuat të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përfshirë akreditimin e rrjeteve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

### **Nënshkruesit ekspertë:**

1. Prof. dr Dragan Gjorgjev, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Maqedonia e Veriut
2. Ass. Prof. Mirjana Dimovska, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Maqedonia e Veriut
3. Prof. dr Zorana Jovanović Andersen, Universiteti i Kopenhagës, Kopenhagë, Kryetare e Komitetit të Mjedisit dhe Shëndetit të Shoqërisë Evropiane të Frymëmarrjes, Danimarkë
4. Prim. dr Elizabet Paunović, Ish Drejtuese e Qendrës Evropiane të OBSH-së për Mjedisin dhe Shëndetin (OBSH/ECEH), Serbisë
5. PhD Vlatka Matković, Health & Environment Alliance (HEAL), Belgium
6. Prof. dr sc. Antigona Ukehaxhaj, Specialiste e Shëndetit Publik, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Prishtinë, Kosovë
7. MD PhD Branislava Matić Savićević, Serbisë
8. Prof. dr Marija Jevtić, Fakulteti i Mjekësisë Universiteti i Novi Sadit, Anëtar i Asociuar i Akademisë së Shkencave Mjekësore të Shoqërisë Mjekësore Serbe, Serbi
9. Prof. dr Sanja Bijelović, Instituti i Shëndetit Publik i Vojvodinës, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Novi Sadit, Serbi
10. Prof. dr Zarema Obradović, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti për Studime Shëndetësore Sarajevë, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, Bosnje dhe Hercegovinë
11. Prim Dr Spec Tomica Anchevski, Specialist i mjekësisë interne, Spitali i përgjithshëm Kumanovë, Shoqata e mjekëve për mjedisin jetësor MADE, Maqedonia e Veriut
12. Prof. dr Maida Mulić, Instituti i Shëndetit Publik të Tuzlës, Fakulteti i Mjekësisë Universiteti i Tuzlës, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, Bosnje dhe Hercegovinë
13. Assoc. prof. dr Gazmend Zhuri, Anëtar i Shoqatës së Pulmologëve të Kosovës, Specialist i Sëmundjeve të frymëmarrjes në Poliklinikën REZONANCA
14. Mr sc. MD Milkica Grabež, Fakulteti i Mjekësisë Universiteti i Banja Lukës, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë
15. Dr Borko Bajić, Instituti i Shëndetit Publik të Malit të Zi, Mali i Zi

Publikuar më 2 Qershor 2022